Kjo platformë duhet të sigurojë mbrojtje kundër sulmeve të aplikacioneve web dhe duhet të punojnë në modalitetin “Reverse Proxy” bazuar në një infrastrukturë të mirëmbajtur nga vetë prodhuesi.

Kërkesat për WAF:

Zgjidhja duhet të ofrohet si “Software as a Service” me shërbime proxy të vetë prodhuesit.

Zgjidhja duhet të ofrojë POP-e në mbarë botën duke minimizuar vonesat në përpunimin e kërkesave sipas vendodhjes së klientit.

Zgjidhja duhet të jetë e menaxhueshme nëpërmjet një ndërfaqe intuitive web apo API. Të gjithë elementët për konfigurimet duhet të jenë të disponueshme njësoj përmes GUI dhe API.

Zgjidhja duhet të mbrojë aplikacionet nga sulmet e mëposhtme:

- Backdoor
- Cross Site Scripting
- Illegal Resource Access
- Remote File Inclusion
- SQL Injection

Zgjidhja duhet të përfshijë shërbim për parandalimin e sulmeve DDoS dhe të ofrojë mbrojtje nga vet prodhuesi për zbutjen e këtyre sulmeve.

Zgjidhja duhet të përdorë klasifikimin e klientit gjatë një sulmi DDoS në mënyrë që të bëjë dallimin midis trafikut të bërë nga njerëzit dhe atij BOT.

Nëse klasifikimi nuk është i qartë atëherë zgjidhja duhet të zbatohet të paktën sfidat e mëposhtme:

- Cookie challenge
- Java Script Challenge
- Captcha Challenge.

Prodhuesi duhet të ketë një ekip të dedikuar për kërkimet, analizimet e kërcënimeve më të fundit dhe të aplikojë nënshkrimet e duhura sapo të identifikohet një kërcënim.

Zgjidhja duhet të integrohet me sistemet SIEM. Loget duhet të vijnë nga të gjitha pikat e aksesit që përpunojnë të dhënat e klientit, si dhe të perfshijnë të gjitha loget e aksesit dhe ato të shkeljeve të sigurisë.

Zgjidhja duhet të ofrojë mbështetje të plotë për IPv6 dhe HTTP2 ndërmjet: klientit dhe infrastruktures së vetë prodhuesit, si edhe infrastrukturës së prodhuesit dhe vetë serverit të aplikacionit.

Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të integrohet me ofrues identiteti të jashtëm për autentikimin e administratorëve të sistemit. SAML duhet të suportohet dhe të ketë mundësi të caktojë rolet bazuar në autentikimin SAML.

Zgjidhja duhet të jetë në përputhje me Level 1 PCI DSS 3.2.1 SP dhe të ketë certifikim SOC 2 Type 2. Zgjidhja duhet të nënshtrohet auditimeve të rregullta nga auditime të jashtme.

Përpunimi i të dhënave të klientit duhet të bëhet në memorjen operationale të pajisjeve dhe loget e ruajtura duhet të kalojnë nëpërmjet një procesi automatik për fshehjen apo transformimin e të dhënave që lidhen me të dhënat personale, si kartat e identitetit apo të dhënat e mbrojtura me ligj.

Zgjidhja duhet të mbështesë izolim rajonal dhe të ketë aftësinë për konfigurimin e shërbimeve në mënyrë të tillë që të dhënat të përpunohen dhe dorëzohen brenda vendeve të EU.

Zgjidhja duhet të përfshijë një mekanizëm built-in CAPTCHA për të kryer verifikimin që sesioni po përdoret nga një njeri.

Zgjidhja duhet të sigurojë klasifikimin e klienteve pa shtuar një kod shtesë në mbi 800 klasifikime të ndryshme duke përfshirë por jo limituar në kategoritë e mëposhtme: HackingTools, Masking Proxy, SeachBot, Vulnerability Scanner, DDoS Bot, SpamBot, etj.

Zgjidhja duhet të përfshijë mekanizëm për bllokimin e bots bazuar në klasifikimin e klientit. Në rast dyshimi duhet të ketë mekanizëm për injektimin e cookie, Javascript, shfaqjen e një testi CAPTCHA për sesione të zgjedhura.

Zgjidhja duhet të suportojë mekanizmat e balancimit të ngarkesës për trafikun drejt serverit të aplikacionit në skenaret: një DC, DC të shumëfishta. Zgjidhja duhet të përfshijë të paktën algoritmat "Least Pending Requests" dhe "Least Open Connection".

Zgjidhja duhet të ofrojë vecori të dhomës së pritjes (Waiting Room), e cila duhet të lejojë caktimin e një pragu për vizitorët në website edhe kur ky numër tejkalohet. Zgjidhja duhet të drejtojë këta vizitorë drejt një hapësire virtuale dhe të trajtojë bazuar në funksionin First-In/ First-Out, duke ju prezantuar edhe kohën e parashikuar të pritjes.

Zgjidhja duhet të vendosë se cilës pikë aksesit do të dërgohet trafiku midis rrjetit të prodhuesit dhe serverit të klientit. Transferimi i trafikut ndërmjet pikave të aksesit duhet të bëhet nëpërmjet lidhjeve të brendshme të vetë prodhuesit.

Zgjidhja duhet të ofrojë disponueshmeri të të dhënave në sistem për një periudhë kohe prej 30 ditësh.

Mbrojtja DNS

Zgjidhja duhet të ofrojë mbrojtje për serverat DNS nga sulmet DDoS. Mbrojtja të jetë e disponueshme në formën Proxy DNS ose të lejojë një zonë pritje në anën e infrastruktures së prodhuesit.

Zgjidhja duhet të lejojë konfigurimin e rekordeve TXT për Domain-et, zgjidhja e cila është ridrejtuar te serverat e prodhuesit duke përdorur rekordet CNAME.

Zgjidhja duhet të suportoje konfigurimin e një server DNS sekondar. Transferimi i zonës duhet të suportohet ndërmjet serverit primar të DNS dhe atij të mbrojtur sekondar.

SSL

Prodhuesi duhet të ketë aftësinë për të gjeneruar një certifikatë web të besuar dhe të ketë mundësinë për të importuar një certifikatë RSA ose ECC të gjeneruar nga klienti.

Zgjidhja duhet të suportoje SNI (Server Name Indication extension to TLS) por gjithashtu të mbështesë klientet pa suport SNI.

Zgjidhja duhet të detyrojë heder HSTS (Strict Transport Security) të vendoset për faqet e aktivizuara SSL/TLS.

Zgjidhja duhet të suportoje ofruesit e palëve të treta Cloud HSM për të ofruar mekanizma të ruajtjes së celësive private në përputhje me standartet më të larta.

Zgjidhja duhet të verifikojë certifikatat e klientit dhe të kalojë të dhënat e saj si (certifikatën e plotë në formatin Base64, gjurmën e gishtit të certifikatës SHA1, emrin e përbashkët dhe numrin serial) tek serveri i aplikacionit në format http.

Zgjidhja duhet të suportoje një autentikim të ndërsjellë (mTLS) midis infrastrukturës së prodhuesit dhe origjinës së serverave.

Zgjidhja duhet të ketë mundësi për të zgjedhur kodet e përdorura për site të vecantë. Zgjidhja e kodeve të jetë e disponueshme në një ndërfaqe grafike të përdoruesit.

Zgjidhja duhet të suportoje TLS Resumption (me përdorimin e identifikuesve të sesioneve apo biletave të sesioneve) dhe OSCP Stapling për të përmirësuar funksionimin e lidhur me SSL/TLS dhe për të reduktuar vonesat.

ROLET

Zgjidhja duhet të ofrojë një engine fleksibel për shkrimin e roleve e cila përcakton saktësisht kriteret dhe veprimet e bashkëngjitura në rol. Kriteret minimale të disponueshme në rol duhet të jenë si më poshtë:

- Geolocation
- Header/cookie value
- Source ASN
- HTTP Method
- POST parameters/values
- TLS version and cipher used within the session
- Time of day and day of year.
- Number of requests sent to the IP in a last minute.

Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të gjenerojë një faqe error në formatet HTML, JSON dhe XML për klientët API.

Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të modifikojë kërkesat dhe përgjigjet http në mënyrë të menjëhershme duke shtuar, hequr heder-at apo skedaret e zgjedhur.

CDN

Zgjidhja duhet të përfshijë funksionalitete CDN, ne vecanti optimizimin e caching dhe përmbytjes.

Funksionaliteti Cache duhet të suportojë modele të paracaktuar të pattern-ve për lloje përmbytjesh specifike. Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të shkruajë role të detajuara që specifikojnë kushtet e ruajtjes së përmbytjes, kohën bazuar në: llojin e përmbytjes, cookies, ID e klientit, parametrat dhe më shumë.

Funksionaliteti Cache duhet të përfshijë funksione të profilizimit dinamik për të prezantuar caching për përmbytjet që zakonisht nuk trajtohen si statike.

Funksionaliteti CDN duhet të suportojë kompresimin e përmbytjes on-the-fly, minifikimi, whitespaces, komentet apo kompresimi i imazhit duke përfshirë pasqyrimin progresiv të imazhit.

MBROJTJE DDOS PËR WEBSITE

Zgjidhja duhet të ofrohet si një shërbim always-on e cila zbut menjëherë çdo lloj ose madhësi të sulmit DDoS që synon aplikacionet në internet.

Websitet duhet të jenë të mbrojtura nga çdo tip sulmi DDoS përfshirë këtu: sulmet në rrjet Layer 3 / 4, sulmet të aplikacioneve Layer 7.

NGJARJET, DASHBOARD, ANALITIKA E SULMEVE

Zgjidhja duhet të ketë përmbytje vizive të gatshme të cilat të tregojnë numrin e kërkesave në kohë për kontakte faqesh të caktuara, numrin e sulmeve të një kategorie të caktuar, vendodhjet më të shpeshta të vizitorëve, bandwidth-in, numrin e kërkesave të përfunduara me error apo vonesa midis infrastrukturës së prodhuesit dhe serverave të aplikacioneve të klientit.

Prodhuesi duhet të paraqesë shkeljet e sigurisë në mënyrë të lehtë për tu interpretuar, të grupuara në sesione, incidente dhe informacion shtesë të Inteligjencës së Kërcënimeve për të analizuar sa me qartë.

Cdo ngjarje e shkeljes së sigurisë duhet të ketë një ID Incident dhe me një session nga një session ID.

Ngjarja duhet të përfshijë përmbytjen në të cilën është regjistruar përmbytja me qëllim të keq.

Zgjidhja duhet të përfshijë sugjerime të gjeneruara automatikisht në lidhje me konfigurimin e vet zgjidhjes të cilat janë gjeneruar në kohën e ekzekutimit në mënyrë dinamike. Sugjerimet duhet të përfshijnë minimumi:

Ekspozimi i serverave të aplikacioneve në internet duke anashkaluar CWFAP.

Adresa IP të zhbllokuara me reputacion të keq ose ka përjashtime për adresat që sulmojnë në mënyrë aktive klientë të tjerë.

Politika e mbrojtjes joaktive ose e vendosur në modalitetin e monitorimit.

Zgjidhja të përfshijë një dashboard në të cilin të shfaqen sulmet e sistemit sipas incidenteve:

- sasia dhe rëndësia e ngjarjeve apo incidenteve të ndodhura,
- vendi i origjinës,
- llojet e shkeljeve,
- llojet e mjeteve të përdorura në sulme,
- burimet që janë sulmuar,

Zgjidhja duhet të përfshijë një aplikacion falas për telefonat inteligjent Android dhe iOS që ofron shikueshmeri në sinjalizimet aktuale, statistikën e trafikut të rrjetit, kërkesat e ofruara dhe të bllokuara, incidentet dhe sugjerimet.

Aplikacioni duhet të mbështesë njoftimet e incidenteve kritike dhe përditësimet për cilësimet e serverit të aplikacionit.

Licensimi

Zgjidhja të përfshijë licensim për mbrojtje të trafikut 20Mb bandwidth të pastër për një periudhë një vjecare.

Zgjidhja të përfshijë licensim të trafikut 20Mb bandwidth për analizimin e ngjarjeve për një periudhë një vjecare.

Zgjidhja duhet të ofrojë mbrojtje të 8 aplikacioneve web për një periudhë një vjecare.

5.4 Sistem për të menaxhuar aksesin dhe identitetin e userave (Hybrid IAM Solution).

Kërkohej një platformë për sigurinë e identitetit të përdoruesve me funksione MFA, SSO dhe aftësinë e menaxhimit të tyre.

Karakteristikat e përgjithshme:

Përdoruesit e AD duhet të kenë mundësinë e hyrjes në kompjuter me dual autentikim, të rivendosë fjalëkalimin apo zhblllokojë llogarinë e tij.

Përdoruesit e AD të kenë një identitet për të aksesuar me lehtësi të gjitha aplikacionet e kompanisë nëpërmjet një hyrje të vetme dhe sinkronizimit të fjalëkalimit të tyre.

Përdoruesit e AD të kryejnë rivendosje të fjalëkalimit dhe të zhblllokojnë llogarinë pa kompromentuar sigurinë.

Përdoruesit e AD të marrin njoftime periodike të personalizuar në mënyrë automatike mbi skadimin e fjalëkalimit dhe llogarisë së tyre.

Përdoruesit e AD të zbatojnë politika për fjalëkalime granulare me rregulla të personalizueshme.

Përdorues të AD të kenë mundësi të përditësojnë të dhënat e tyre personale në AD.

MFA:

Fortifikim i pajisjeve (Windows, mac OS, linux), VPN OWA dhe aplikacionet e kompanisë të identifikohen me MFA duke zgjedhur metoda si: biometrike, TOTP, aplikacione autentikimi (duo, google, microsoft).

Të verifikojë në mënyrë automatike aksesin në resorset e kompanisë përmes autentikimit bazuar në kontekst duke përdorur detaje si: ip adress, koha e aksesit, vendodhja gjeografike, pajisja e përdorur.

SSO:

Tu mundësojë përdoruesve të AD akses në çdo aplikacion të kompanisë të integruar me AD, duke u identifikuar vetëm njëherë me fjalëkalimet e tyre.

Të parandalojë sulmet bazuar në kredenciale për hyrjet në aplikacione duke përdorur vërtetim pa fjalëkalim të mbështetur nga MFA.

Self -Service për menaxhimin e sigurisë fjalëkalimet:

Tu mundësojë përdoruesve rivendosjen e fjalëkalimit dhe zhbllokimin e llogarisë pa ndërhyrjen e help desk.

Sinkronizim të fjalëkalimeve të AD me aplikacionet e integruara në të, për të mos humbur aksesin e shërbimeve dhe sistemeve të brendshme.

Të personalizojë politikat e fjalëkalimeve në nivel OU apo Grupi të përdoruesve të ndryshëm të AD dhe platformave të tjera të kompanisë.

Aktivizimi i punës në distancë:

Të aktivizojë përditësim automatik të ndryshimeve të fjalëkalimeve të përdoruesve të domain të cilët ndryshojnë kredencialet gjatë kohës që janë të lidhur me VPN.

Të ofrojë një portal të sigurt bazuar në web për punonjësit që janë të lidhur në distancë për të ndryshuar fjalëkalimet e domainit dhe aplikacionit të kompanisë.

Të lajmërojë përdoruesit e kompanisë në ambient apo distance për periudhën e afërt të skadimit të fjalëkalimit dhe llogarisë me: SMS, emali apo njoftime në aplikacione të treta.

Self-Service:

Të lejojë përdoruesit të përditësojnë atributet e tyre si: emali, numri i celularit apo fotografi.

Të lejojë përdoruesit të kërkojnë lehtësisht për përdoruesit e tjerë, kontakte apo grupe të kompanisë.

Të lejojë përdoruesit të zgjedhin politikat e grupeve të përzgjedhura kur roli i tyre ndryshon pa patur nevojën të kontaktojnë Helpdesk.

Kërkesat e hardware të cilat vihen në dispozicion nga OSHEE:

Procesor: min 2 ghz; Ram: min 8gb; Disc: min 100Gb

Platformat që duhet të suportohen: Windows Server 2022, Windows Server 2019, Windows Server 2016, Windows Server 2012 R2, Windows Server 2012, , Windows 11, Windows 10, Windows 8, Windows 7, Windows XP

Databaza që duhet të suportohen: PostgreSQL (default), and MS SQL

Licensimi:

Licensimi të ofrohet i përhershëm me mbështetje suporti për një periudhë 1 vjecare për 3000 usera domain.

Licensim për MFA të ofrohet i përhershëm me mbështetje suporti për një periudhë 1 vjecare për 3000 usera domain.

Licensim i pajtueshëm për 2000 SMS për një periudhë 1 vjecare.

5.5 Smart DNS Proxy Server

OSHEE sh.a. kërkon të prokurojë një zgjidhje on-prem, plotësuese të zgjidhjes Cloud për menaxhimin e plotë të trafikut të internetit.

Zgjidhja duhet të ofrojë:

- Qendërzim dhe vizibilitet të plotë të trafikut DNS;
- Shpërndarja e paketave nëpërmjet load balancer;
- DNS Cache, përsheptim të resolvimit të faqeve;
- Enkriptim të trafikut DNS duke kaluar trafikun DNS over https;

- Mundësia për të bërë HA (disponueshmëri të lartë) më shumë upstream servers;
- Sigurimi i AD forwarders me një layer në DMZ për të mos dalë direkt në internet;
- Menaxhim i faqeve web me listë të lejuar, listë të ndaluar (block list/allow list);
- Aplikimi i politikave nëpërmjet mekanizmave RegEx ose Wildcard për të bllokuar faqet web;
- Log-e për faqet e bllokuara filtër sipas faqes web që është bërë query;
- Log-e për faqet e bllokuara filtër sipas IP e klientit që ka bërë query;
- Statistika afatgjata.
- Log-et të ruhen në databazë që mund t'i kërkojë me vonë.
- Audit log. Të mundësojë filtrimin e faqeve që janë kërkuar me shumë (kështu këto faqe mund t'i shtohen në white ose black list).
- Live data, pasqyrë e faqeve të bllokuara ose lejuara në kohë reale.
- Bllokim të reklamave në faqe të ndryshme duke parandaluar user-at për instalime malware të pavullnetshme
- Shtresëzimi i DNS layers për të rritur sigurinë maksimale midis zonave.

Zgjidhja Smart DNS Proxy Server të ofrohet për 1500 përdorues.

5.6 Sistem për të ofruar sigurinë e shërbimit DNS dhe Web Surfing (Cloud SWG solution).

Zgjidhja duhet të jetë një platformë bazuar në cloud, e cila ofron nivele të shumta mbrojtjeje kundër kërcënimeve të bazuara në internet.

Zgjidhja të ofrojë mbrojtje nga kërcënimet duke u integruar me platforma të tjera si; Web Gateway, Firewall, DNS layer protection, DLP, Cloud Access Security Broker, Remote Browser Isolation.

Siguria e shtresave të DNS:

Të ofrojë bllokim të domeneve të malware, phishing, botnet apo reziqe të tjera të larta.

Të ofrojë bllokim të trafikut direkt në IP për C2 callback që anashkalojnë DNS.

Të ofrojë bllokim të kërkesave për destinacione me qëllim të keq dhe të padëshiruar përpara se të vendoset lidhja.

Ndalim të kërcënimeve mbi cdo portë ose protokoll përpara se të arrihet lidhja me rrjetin ose me pikat fundore të tij.

Siguria e portave Web:

Të ofrojë dekriptim dhe inspektim i trafikut ssl (https).

Të krijojë lista të personalizuar me funksion lejo/blloko apo filtrim të web te: domaine dhe url.

Të ofrojë bllokim të url dhe skedarëve bazuar në modulet software të antivirus dhe mbrojtjen e malware.

Të përdorë sandbox për analizimin e malware dhe skedarëve të dyshimtë të paktën 500 mostra në ditë.

Të përdorë sigurinë retrospektive për identifikimin e skedarëve të mëparshëm të dëmshëm apo me qëllim të keq.

Të përdorë IPsec tunnels, PAC files dhe Proxy channing për shikueshmëri të plotë kontrollë në nivel url-se dhe mbrojtje të avancuar nga kërcënimet.

Të përfshijë Proxy të plotë bazuar në cloud i cili të mund të regjistrojë dhe inspektojë të gjithë trafikun në internet me qëllim transparence, kontrolli dhe mbrojtje me të avancuar.

Politikat e sigurisë bazuar në cloud dhe Firewall:

Të zbulojë dhe bllokojë shadow IT me mjete që kanë shikueshmëri mbi aplikacionet cloud dhe shërbimet e përdorura të kompanisë të vlerësuara si risk.

Të krijojë politika me kontrolle të hollësishme në aplikacionet e zgjedhura, bllokim të (uploads, attachments, posts).

Të krijojë politika në layer 3 / 4 për të bllokuar ip-te, portat dhe protokollet specifike.

Të ketë mundësi të terminojë tunelet IPsec.

Të ofrojë shikueshmëri dhe kontroll për trafikun që vjen nga kërkesat që shkojnë në internet nga të gjitha portat dhe protokollet.

Të ketë mundësi të përdorë të dhënat e pajisjeve të sigurisë dhe përgjigje të veprimeve të automatizuara.

Të ketë mundësi të integrohet me pajisjet e sigurisë Cisco të OSHEE për të grumbulluar aktivitetin e tyre.

Menaxhimi dhe raportet:

Të krijojë politika dhe raporte sipas përdoruesve, pajisjeve në rrjet apo dhe ato roaming.

Të menaxhojë duke përdorur një konsolë të qëndërzuar, të personalizojë bllokimin e faqeve apo të anashkalojë ato.

Të kërkojë në kohë reale mbi aktivitetin dhe të nxjerrë me lehtësi ngjarjet kryesore.

Të ofrojë mbrojtje për pajisjet mobile iOS dhe android.

Të percaktojë sistemet e kompromentuara duke përdorur në kohë reale raportet e aktivitetit të sigurisë.

Licensimi:

Zgjidhja të përfshijë licenca të pajtueshme për 1500 përdorues për një periudhë një vjeçare 24 x7.

Instalimi, konfigurimi dhe testimi duhet të bëhet nga ofertuesi, zgjidhja duhet të dorëzohet e plotë (Turnkey Solution).

Zgjidhja të ofrojë mundësi për të parë dhe hapur trouble ticket me qendrën suportin e autorizuar të prodhuesit të pajisjes.

5.7 Certifikatë SSL OV wildcard

Për rritjen e sigurisë së komunikimit në web, OSHEE sh.a. kërkon të prokurojë:

- 4 wild card SSL për faqet web (*.oshee.al, *.fshu.al, *.ossh.al, *.ftl.al);
- Certifikatë ssl për faturën online;
- Certifikatë ssl për mail server

5.8 Software për Vulnerability Assessment

Zgjidhja duhet të ofrojë karakteristikat si më poshtë:

- Real-Time Vulnerability Updates
- Vulnerability Scanning
- Web Application Scanning
- Ability to add Fully Qualified Domain Names (FQDN)
- Ability to Add External Attack Surface Domains

-
- Scan Cloud Infrastructure

Zgjidhja duhet të ofrojë mundësi skanimit për të identifikuar cënueshmëri (vulnerabilities) në pajisjet e rrjetit, sistemet operative, aplikacionet dhe bazat e të dhënave.

Zgjidhja duhet të ofrojë mundësinë që përdoruesit të mund të krijojnë politika të personalizuar të vlerësimit të cënueshmërisë, të përshtatura për nevojat e tyre specifike.

Zgjidhja të ketë mundësinë e operimit pa agjente, duke kryer skanimet në distance pa kërkuar instalimin e ndonjë software në sistemet e synuara.

Zgjidhja të gjenerojë raporte të detajuara duke përshkruar cënueshmëritë e zbuluara, nivelin e tyre të rëndësisë dhe hapat e rekomanduar për ndalueshmëri. Këto raporte të mund të personalizohen dhe eksportohen në formate të ndryshme për analizë dhe veprim të mëtejshëm.

Zgjidhja të ketë mundësinë të integrohet me zgjidhje dhe mjetet e tjera të sigurisë, si sistemet e Menaxhimit të Informacionit dhe Ngjarjeve të Sigurisë (SIEM), për të lehtësuar proceset e menaxhimit të cënueshmërisë dhe për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme të sigurisë.

5.9 Licenca për lidhje në distancë të PC

2 licenca software për menaxhimin në distancë të PC me parametrat minimalë të mëposhtëm:

- Lidhje të njëkohshme.
- File sharing.
- Siguri të lidhjes.
- Akseset të pajisjeve me SO të ndryshëm.
- Mundësi integrimi me sisteme të Help Desk

Kohëzgjatja e licensave: 1 vit nga implementimi i licenses.

5.10 Licenca ThinkCell

Think-Cell është një program, i cili integrohet në PowerPoint dhe Excel dhe është projektuar posaçërisht për të bërë krijimin e slideve të biznesit në një kohë më të shpejtë. Sjell mbi 40 lloje të grafikëve, përmirësime vizuale të shtuara nga të dhënat dhe veçori të tjera unike.

- Programi përshtatet me paketat e Microsoft Office 2016/2019/2021

Licenca duhet të jetë minimalisht për 15 përdorues.

Kohëzgjatja e licenses: 1 vit nga implementimi i licenses

6. Shërbime Instalimi dhe Implementimi.

6.1 Shërbime Instalimi dhe implementimi në site

Operatori ekonomik duhet të bëjë instalimin dhe konfigurimet që janë ofruar në këtë prokurim duke mos shkaktuar down-time në sistemet kryesore të kompanisë.

SHËRBIMET QË DUHET TË KRYHEN

Sistem për mbrojtjen e email nga sulmet me të sofistikuarat si ransomware, spear phishing, apo business compromise email

-
- Përgatitje e skenarit për implementimin.
 - Implementimi dhe konfigurimi i sistemit.
 - Licensimi i tij.
 - Dokumentim të implementimit.

Upgrade i licencave ekzistuese të sistemit për autentikim të dyfishtë Duo Beyond

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i licencave.
- Implementimi dhe integrimi me zgjidhjen ekzistuese.
- Konfigurimi dhe testimi i aplikacioneve ekzistuese
- Testimi dhe aksesimi.
- Dokumentim të implementimit

Sistem mbrojtje DDoS për aplikimet publike Web (OSHEE web applications).

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Implementimi dhe konfigurimi i sistemit.
- Licensimi i tij.
- Testimi dhe aksesimi.
- Dokumentim të implementimit.

Sistem për të menaxhuar aksesin dhe identitetin e userave (Hybrid IAM Solution).

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Implementimi dhe konfigurimi i sistemit.
- Licensimi i tij.
- Testimi dhe aksesimi.
- Dokumentim të implementimit.

Sistem për të ofruar sigurinë e shërbimit DNS dhe Web Surfing (Cloud SWG solution).

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Implementimi dhe konfigurimi i sistemit.
- Licensimi i tij.
- Testimi dhe aksesimi.
- Dokumentim të implementimit.

Shërbime instalimi dhe konfigurimi të software, hardware si dhe verifikimi i garancive për suport për periudhën një vjeçare për gjithë produktet në këtë prokurim.

- Përgatitja e skenarit e detajuar për ndërtimin, instalimin, konfigurimin e shërbimeve.
- Përgatitja e skemave të implementimit.
- Testimi i shërbimeve të implementuara.
- Dokumentimi i çdo instalimi, konfigurimi sistemesh: software, hardware.
- Dokumentimi i suportit, mirëmbajtjes së sistemeve të implementuara.

6.2 Shërbime Mirëmbajtje/Suporti Onsite dhe Remote

Objektivi i shërbim mirëmbajtje:

OSHEE sh.a, më anë e këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre, sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware dhe software të mos afektojnë punën.

Shërbim mirëmbajtje:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbim mirëmbajtje për pajisjet ekzistuese aktualisht në gjendje pune dhe pajisjet e reja në këtë prokurim.

Termet për shërbim mirëmbajtje:

- Operatori ekonomik duhet të ketë skuadër të dedikuar për suportin, mundësi të qëndrimit të thirrjeve dhe të një kontakti të vetëm që do koordinojë dhe menaxhojë thirrjet e OSHEE Group sh.a.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë kohë të shpejtë të pranimit të thirrjes, maksimumi 1 orë nga log-ini i thirrjes së OSHEE Group sh.a.
- Tekniku duhet të paraqitet në vendndodhjen e OSHEE Group sh.a. brenda 4 (katër) orëve nga log-ini i thirrjes dhe raportimit të problemit, në rast se thirrja konsiderohet urgjente dhe brenda ditës së nesërme të punës për thirrje jo urgjente. Tekniku gjatë kohës së paracaktuar duhet të fillojë diagnostikimet on-site dhe mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë gatishmërinë e suportit 24/7.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë mirëmbajtje të plotë të hardware-t me zëvendësim falas të pajisjes ose pjesëve të këmbimit në rast defekti.
- Në rast të ndërrimit të pajisjeve, duhet të ndërrojë pajisjet e dëmtuara dhe të kryejë konfigurimet bazë të nevojshme pas ndërrimit.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë se do të kryejë diagnostikime proaktive me mbështetje të vendorit dhe hapje case TAC, Update të software-ve të Sistemit të Operimit (OS), duke përfshirë minor, major releases.
- Operatori ekonomik duhet të kryejë update të Software-ve.
- Operatori ekonomik duhet të kryejë ndryshime në konfigurime dhe rikonfigurime sipas kërkesave të OSHEE sh.a, në varësi të ndryshimit të dizajnit të Network-ut.

Nivelet e shërbimit të mirëmbajtjes dhe proceset:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar me poshtë:

1. Suport proaktiv.

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, shërbime dhe suport proaktiv, të cilët duhet të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe duhet të mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e suportit proaktiv, duhet të kryhen pranë ambienteve të OSHEE GROUP sh. a, përveç rasteve kur OSHEE GROUP sh.a. përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

2. Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e OSHEE GROUP sh.a).

Operatori ekonomik duhet të jetë në dispozicion gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Diele, 24/7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar i OSHEE GROUP ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin *Alarm Madhor* do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për shërbime riparimi të ndërmarrë në rast të keqfunksionimit të sistemeve të mbuluara që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OSHEE GROUP sh.a, të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin "*Alarmeve Madhore*", duhet të adresohen nën Shërbime të Suportit proaktiv.

3. Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

OSHEE sh.a. do të njoftojë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion dhe do të presë të kontaktohet nga ne me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtje dhe Upgrade në Infrastrukturën aktuale të memories dhe procesimit në Data Center primary Site dhe DR Site.

Afatet e ekzekutimit 12 muaj sipas termave te references.

Grafiku i implementimit dhe mirembajtjes se sherbimeve/licensesave.

Nr	Description	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10	M11	M12
1	Shërbime Instalimi dhe implementimi në site												
2	Shërbime Mirëmbajtjeje/Suporti Onsite dhe Remote												

Sasia e mallit që kërkohet:

NR	Përshkrimi	Njesia	Sasia
1	Garanci për Suport për Infrastrukturen e Serverave		
1.1	Garanci për Suport DELL Servers	vite	1
1.2	Garanci për Suport HPE Servers	vite	1
1.3	Garanci per Suport Fujitsu Server	vite	1
1.4	Garanci për Suport për Server Room (Primare & Disaster Recovery)	vite	1
2	Garanci për Suport për Data Storages		
2.1	Garanci për Suport për Data Storage UNITY 400 (Primary Site)	vite	1
2.2	Garanci për Suport për Data Storage DX 200 (Primary Site)	vite	1
2.3	Garanci për Suport për Dedup Appliances DD6300 (Primary Site) DD6300	vite	1
3	Garanci për Suport për Infrastrukturën e Network		
3.1	Garanci për Suport për Network Routers &Switches	vite	1
3.2	Garanci për Suport për SAN Swithces	vite	1
3.3	Garanci për Suport për Cisco Prime Infrastructure	vite	1
3.4	Garanci për Suport për ISE, Wireless Controller, Access Point, Cisco WebEx subscription)	vite	1
3.5	Garanci për Suport për Wireless Controller	vite	1
3.6	Garanci për Suport për Access Point	vite	1

3.7	Garanci për Suport për Cisco WebEx subscription	vite	1
3.8	Garanci për Suport për Cisco Firewalls ASA Firewall	vite	1
3.9	Garanci për Suport për Cisco Firewalls Cisco Firepower Management	vite	1
3.10	Garanci për Suport për Cisco Firepower Firewall, FPR Subscription	vite	1
3.11	Garanci për Suport për DUO Beyond	vite	1
3.12	Garanci për Suport për Cisco AnyConnect	vite	1
4	Garanci për Suport për Sistemet Software		
4.1	Garanci për Suport për Backup Software ekzistues Dell PowerProtect	vite	1
4.2	Garanci për Suport për Software ekzistues VMware	vite	1
4.3	Garanci për Suport për Software ekzistues VEEAM	vite	1
4.4	Garanci për Suport CheckPoint Firewalls Software	vite	1
4.5	Garanci për Suport Imperva DB Audit & Web Application Firewall	vite	1
4.6	Garanci për suport i licensave ekzistuese EDR Symantec Endpoint Security Complete	vite	1
4.7	Garanci për Suport dhe Mirëmbajtje Exchange Server 2019	vite	1
4.8	Garanci për Suport i licensave SolarWinds ekzistuese	vite	1
4.9	Garanci për Suport i licensave Manage Engine ekzistuese	vite	1
5	Upgrade për Hardware dhe Software		
5.1	Sistem për mbrojtjen e email nga sulmet më të sofistikuar si ransomware, spear phishing, apo business compromise email	vite	1
5.2	Upgrade i licensave ekzistuese të sistemit për autentikim të dyfishtë Duo Beyond	vite	1
5.3	Sistem mbrojtje DDoS për aplikimet publike Web (OSHEE web applications)	vite	1
5.4	Sistem për të menaxhuar aksesin dhe identitetin e userave (Hybrid IAM Solution)	vite	1
5.5	Smart DNS Proxy Server (on-prem)	vite	1
5.6	Sistem për të ofruar sigurinë e shërbimit DNS dhe Web Surfing (Cloud SWG solution)	vite	1
5.7	Certifikatë SSL OV wildcard	vite	1
5.8	Software për Vulnerability Assessment	vite	1
5.9	Licenca për lidhje në distancë të PC	vite	1
5.10	Licenca ThinkCell	vite	1
6	Shërbime Instalimi dhe Konfigurimi		
6.1	Shërbime Instalimi dhe implementimi në site	muaj	2
6.2	Shërbime Mirëmbajtjeje/Suporti Onsite dhe Remote	vite	1

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Specifikimet teknike të hartuara:

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

NR	Përshkrimi	Njesia	Sasia
1	Garanci për Suport për Infrastruktura e Serverave		
1.1	Garanci për Suport DELL Servers	vite	1
1.2	Garanci për Suport HPE Servers	vite	1
1.3	Garanci për Suport Fujitsu Server	vite	1
1.4	Garanci për Suport për Server Room (Primare & Disaster Recovery)	vite	1
2	Garanci për Suport për Data Storages		
2.1	Garanci për Suport për Data Storage UNITY 400 (Primary Site)	vite	1
2.2	Garanci për Suport për Data Storage DX 200 (Primary Site)	vite	1
2.3	Garanci për Suport për Dedup Appliances DD6300 (Primary Site) DD6300	vite	1
3	Garanci për Suport për Infrastruktura e Network		
3.1	Garanci për Suport për Network Routers & Switches	vite	1
3.2	Garanci për Suport për SAN Switches	vite	1
3.3	Garanci për Suport për Cisco Prime Infrastructure	vite	1
3.4	Garanci për Suport për ISE, Wireless Controller, Access Point, Cisco WebEx subscription)	vite	1
3.5	Garanci për Suport për Wireless Controller	vite	1
3.6	Garanci për Suport për Access Point	vite	1
3.7	Garanci për Suport për Cisco WebEx subscription	vite	1
3.8	Garanci për Suport për Cisco Firewalls ASA Firewall	vite	1

3.9	Garanci për Suport për Cisco Firewalls Cisco Firepower Management	vite	1
3.10	Garanci për Suport për Cisco Firepower Firewall, FPR Subscription	vite	1
3.11	Garanci për Suport për DUO Beyond	vite	1
3.12	Garanci për Suport për Cisco AnyConnect	vite	1
4	Garanci për Suport për Sistemet Software		
4.1	Garanci për Suport për Backup Software ekzistues Dell PowerProtect	vite	1
4.2	Garanci për Suport për Software ekzistues VMware	vite	1
4.3	Garanci për Suport për Software ekzistues VEEAM	vite	1
4.4	Garanci për Suport CheckPoint Firewalls Software	vite	1
4.5	Garanci për Suport Imperva DB Audit & Web Application Firewall	vite	1
4.6	Garanci për suport i licensave ekzistuese EDR Symantec Endpoint Security Complete	vite	1
4.7	Garanci për Suport dhe Mirëmbajtje Exchange Server 2019	vite	1
4.8	Garanci për Suport i licensave SolarWinds ekzistuese	vite	1
4.9	Garanci për Suport i licensave Manage Engine ekzistuese	vite	1
5	Upgrade për Hardware dhe Software		
5.1	Sistem për mbrojtjen e email nga sulmet më të sofistikuar si ransomware, spear phishing, apo business compromise email	vite	1
5.2	Upgrade i licensave ekzistuese të sistemit për autentikim të dyfishtë Duo Beyond	vite	1
5.3	Sistem mbrojtje DDoS për aplikimet publike Web (OSHEE web applications)	vite	1
5.4	Sistem për të menaxhuar aksesin dhe identitetin e userave (Hybrid IAM Solution)	vite	1
5.5	Smart DNS Proxy Server (on-prem)	vite	1
5.6	Sistem për të ofruar sigurinë e shërbimit DNS dhe Web Surfing (Cloud SWG solution)	vite	1
5.7	Certifikatë SSL OV wildcard	vite	1
5.8	Software për Vulnerability Assessment	vite	1
5.9	Licenca për lidhje në distancë të PC	vite	1
5.10	Licenca ThinkCell	vite	1
6	Shërbime Instalimi dhe Konfigurimi		
6.1	Shërbime Instalimi dhe implementimi në site	muaj	2
6.2	Shërbime Mirëmbajtjeje/Suporti Onsite dhe Remote	vite	1

7. Garanci për Suport për Infrastruktura e Serverave

Objekti i garancisë për suport.

OSHEE Group sh.a. me anë të këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware të mos afektojnë punën.

Garancia për suport të sistemeve të Serverave

Kompania duhet të ofrojë garanci për suport për serverat aktualisht në gjendje pune dhe sipas tabelës së dhënë në vijim.

Termet e Garancisë për Suport:

- Kompania duhet të ketë skuadër të dedikuar për suportin, mundësi të qëndrimit të thirrjeve dhe një kontakt të vetëm që koordinon dhe menaxhon thirrjet e OSHEE Group sh.a.
- Kompania duhet të sigurojë kohë të shpejtë të pranimit të thirrjes, maksimumi 1 orë nga log-ini i thirrjes së OSHEE Group sh.a.
- Tekniku duhet të paraqitet në vendndodhjen e OSHEE Group sh.a. brenda 4 (katër) orëve nga log-ini i thirrjes dhe raportimit të problemit, në rast se thirrja konsiderohet urgjente, si dhe brenda ditës së nesërme të punës për thirrje jo urgjente. Tekniku gjatë kohës së paracaktuar duhet të fillojë diagnostikimet on-site dhe mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Kompania duhet të sigurojë gatishmërinë e suportit në orarin: 8:30-17:00.
- Kompania duhet të sigurojë garanci për suport të plotë të hardware-it me zëvendësim falas të pajisjes ose pjesëve të këmbimit në rast defekti.
- Në rast ndërrimi të pajisjeve, kompania ofruese e garancisë për suport duhet të ndërrojë pajisjet e dëmtuara dhe të kryejë konfigurimet bazë të nevojshme pas ndërrimit.
- Kompania duhet të sigurojë diagnostikime proaktive me mbështetje të vendor-it dhe hapje case TAC, Update të software-ve të Sistemit të Operimit (OS), duke përfshirë minor, major releases.
- Kompania duhet të kryejë update të Software-ve.

Nivelet e garancisë për suport dhe proceset

Kompania duhet të ofrojë shërbime të Garancisë për suport dhe mirëmbajtjes, sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës së përshkruar më poshtë:

- **Suport proaktiv.**

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, shërbime dhe suport proaktiv, të cilët do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe do të mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rikuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e suportit proaktiv do të kryhen pranë ambienteve të OSHEE Group sh.a., përveç rasteve kur OSHEE Group sh.a. përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

- **Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e OSHEE Group sh.a.).**

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë interval kohor, nga e Hëna në të Premte, 8:00 me 17:00, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. ("Emergency On-Call Hours").

Me termin *Alarm Madhor*, do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për shërbime riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OSHEE Group sh.a. dhe të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin "*Alarmeve Madhore*", duhet të adresohen nën Shërbime të Suporti proaktiv.

- **Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.**

OSHEE sh.a. do të njoftojë Kompaninë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një nderfaqeje web të vënë në dispozicion dhe do të presë të kontaktohet nga Kompania me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Kompania duhet të kontaktojë OSHEE sh.a. dhe të konfirmojë marrjen e Alarmit Madhor, brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. Në momentin e njohjes së thirrjes nga Kompania, OSHEE Group sh.a. do të vendosë në dispozicion informacione të paracaktuara në *Procedurat e Troubleshooting* nga Kompania dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. OSHEE Group sh.a. do të bashkëpunojë me kërkesën e

Kompanisë për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

- **Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.**

Nëse Kompania nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting shkakun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë OSHEE Group sh.a. brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të arritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga OSHEE Group sh.a. dhe do t'i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

- **Veprimtarite e Diagnostikimit dhe Riparimit.**

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Kjo veprimtari duhet të vazhdojë deri sa:

- (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë",
- (b) Tekniku të jetë zëvendësuar me një person tjetër.
- (c) Kompania të përcaktojë, se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose
- (d) Kompania arrin në konkluzionin që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Teknikët e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesin.

Në rast se do jetë i nevojshëm zëvendësimi i pjesëve të këmbimit, atëherë kompania duhet të kryejë të gjitha procedurat respektive me prodhuesin për lokalizimin e pjesës, heqjen, eksportin, transportin, importin, vendosjen dhe rikonfigurimet përkatëse. Kostot e pjesëve të dëmtuara dhe kostot e shërbimit do të merren përsipër nga kompania për të gjithë periudhën e kontratës.

Garanci për shërbime të tjera

Kompania duhet të krijojë/diskutojë me OSHEE Group sh.a. një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

- **Javore**

- (iii) Kontrolle të log-eve të serverave;
- (iv) Mirëmbajtje proaktive;

- **Mujore**

- (i) Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës HW të OSHEE Group sh.a.;
- (ii) Kontroll i detajuar i gjithë log - eve hardware dhe analizë e tyre;
- (iii) Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.

1.1 Garanci për Suport DELL Servers

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese nga Prodhuuesi DELL EMC. Koha e mbulimit me garanci për suport: **1 vit.**

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
PowerEdge R940	SN: 8VTBFV2	1	1 vit
PowerEdge R940	SN: 8VT9FV2	1	1 vit
PowerEdge R940	SN: DYSCMF3	1	1 vit
PowerEdge R940	SN: CYSCMF3	1	1 vit

1.2 Garanci për Suport HPE Servers

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese nga Prodhuksi HPE. Koha e mbulimit me garanci për suport: **1 vit**.

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
ProLiant DL380	CZ29110SCF	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SCD	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SCB	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SC7	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SCC	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SC8	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SC9	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SC6	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SCG	1	1 vit
ProLiant DL380	CZ29110SCH	1	1 vit

1.3 Garanci për Suport FUJITSU Servers

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese nga Prodhuksi Fujitsu. Koha e mbulimit me garanci për suport: **1 vit**.

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
Server Fujitsu Primergy RX2530 M4	SN: YMBQ016954	1	1 vit
Server Fujitsu Primergy RX2530 M4	SN: YMBQ016955	1	
Server Fujitsu Primergy RX2530 M4	SN: YMBQ016957	1	
Server Fujitsu Primergy RX2530 M4	SN: YMBQ016958	1	

Server Fujitsu Primergy RX2530 M5	SN: YMLU002337	1
Server Fujitsu Primergy RX2530 M5	SN: EWAG002957	1
Server Fujitsu Primergy RX2530 M5	SN: EWAG002958	1

1.4 Garanci për Suport për Server Room (Primare & Disaster Recovery)

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese ne room server. Koha e mbulimit me garanci për support : **1 vit.**

Në dhomën e serverave ne DR Site janë të instaluara :

- UPS System (1 copë)
- CRAC system (1 copë)
- Sistem Zjarri (1 copë)

Në dhomën e serverave ne PR Site është janë të instaluara :

- UPS System (2 copë)
- CRAC system (2 copë)
- Sistem Zjarri (1 copë)

8. Garanci për Suport për Data Storages

Objekti i garancisë për suport

OSHEE Group sh.a., me anën e këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware të mos afektojnë punën.

Përshkrimi i Garancisë për suport sipas specifikimeve teknike më poshtë:

Suport Teknik	<p>Nëpërmjet telefonit ose faqes web 24 x 7 me EMC</p> <p>Të ofrohet nga EMC:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgjigje teknike nëpërmjet remote sipas nivelit të sigurisë së problemit. 2. Onsite response (përgjigje në vend). <p>Koha e përgjigjes e kërkuar:</p> <p>Niveli i sigurisë 1: 1 orë, 24x7.</p> <p>Niveli i sigurisë 2: 3 orë; 24x7.</p> <p>Niveli i sigurisë 3: 4 orë lokale biznesi.</p>
----------------------	--

	Niveli i sigurisë 4: 10 orë lokale biznesi.
Përgjigje onsite (në vendndodhje)	Dërgimi i personelit të autorizuar në site për të punuar mbi problemin, pasi kjo shikohet si e nevojshme nga EMC. Të përfshihet vetëm për pajisjen Intervenimi on-site max. 6 orë kohë riparimi Përgjigja onsite (në vendndodhje) të mos aplikohet për software, por të ketë mundësi të blihet veç.
Lëvrimi i pjesëve zëvendësuese	Po (6 orë kohë riparimi).
Të drejtë për Versionet e reja të software	Po
Monitorim dhe riparim nëpërmjet remote 24x7	Po
Akses 24x7 online support	Po

2.1 Garanci për Suport për Data Storage UNITY 400 (Primary Site)

- Garanci për Suport për periudhën 1 vjeçare.
- Ofrim nivel suporti 24x7x4h kohë përgjigje për hardware dhe software.
- DELL EMC 400 - S/N: CKM00191400151

2.2 Garanci për Suport për Data Storage DX 200 (Primary Site)

- Garanci për Suport për periudhën 1 vjeçare.
- Ofrim nivel suporti 8x5 kohë përgjigje për hardware dhe software.
- ET DX200 S4 - S/N: 4601852366.

2.3 Garanci për Suport për Dedup Appliances DD6300 (Primary Site) DD6300

- Garanci për Suport për periudhën 1 vjeçare.
- Ofrim nivel suporti 24x7x4h kohë përgjigje për hardware dhe software.
- EMC DD 6300 - S/N: CKM00180502480.

9. Garanci për Suport për Infrastukturën e Network

Objektivi i garancisë për support:

OSHEE Group sh. a, më anë e këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre, sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware të mos afektojnë punën.

Garancia për suportet e kërkuara:

Kompania duhet të ofrojë garanci për suport për pajisjet e network-ut, aktualisht në gjendje pune dhe sipas tabelës së dhënë në vijim.

Termet e Garancisë për Suport:

- Kompania duhet të ketë skuadër të dedikuar për suportin, mundësi të qendërimit të thirrjeve dhe të një kontakti të vetëm që koordinon dhe menaxhon thirrjet e OSHEE Group sh.a.
- Kompania duhet të sigurojë kohë të shpejtë të pranimit të thirrjes, maksimumi 1 orë nga log-ini i thirrjes së OSHEE Group sh.a.
- Tekniku duhet të paraqitet në vendndodhjen e OSHEE Group sh.a. brenda 4 (katër) orëve nga log-ini i thirrjes dhe raportimit të problemit, në rast se thirrja konsiderohet urgjente dhe brenda ditës së nesërme të punës për thirrje jo urgjente. Tekniku gjatë kohës së paracaktuar duhet të fillojë diagnostikimet on-site dhe mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Kompania duhet të sigurojë gatishmërinë e suportit 24/7.
- Kompania duhet të sigurojë garanci për suport të plotë të hardware-t me zëvendësim falas të pajisjes ose pjesëve të këmbimit në rast defekti.
- Në rast ndërrimi të pajisjeve, kompania ofruese e Garancisë për suport duhet të ndërrojë pajisjet e dëmtuara dhe të kryejë konfigurimet bazë të nevojshme pas ndërrimit.
- Kompania duhet të sigurojë diagnostikime proaktive me mbështetje të vendorit dhe hapje case TAC, Update të software-ve të Sistemit të Operimit (OS), duke përfshirë minor, major releases.
- Kompania duhet të kryejë update të Software-ve.
- Kompania duhet të kryejë ndryshime në konfigurime dhe rikonfigurime sipas kërkesave të OSHEE Group sh.a, në varësi të ndryshimit të dizajnit të Network-ut.

Nivelet e Garancisë për suport dhe proceset:

Kompania duhet të ofrojë shërbime të Garancisë për suport dhe mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

6. Suport proaktiv.

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, shërbime dhe suport proaktiv, të cilët do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe do të mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e suportit proaktiv, do të kryhen pranë ambienteve të OSHEE Group sh.a., përveç rasteve kur OSHEE Group sh.a. përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

7. Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e OSHEE Group sh.a.).

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Dielë, 24/7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "*Alarmeve Madhore*" të raportuara nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin *Alarm Madhor* do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për shërbime riparimi të ndërmarrja në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjehershme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OSHEE Group sh.a., të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin "*Alarmeve Madhore*", duhet të adresohen nën Shërbime të Suportit proaktiv.

8. Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

OSHEE Group sh.a. do të njoftojë Kompaninë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion dhe do të presë të kontaktohet nga Kompania me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Kompania duhet të kontaktojë OSHEE Group sh.a. dhe të konfirmojë marrjen e *Alarmit Madhor*, brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. Në momentin e njohjes së thirrjes nga Kompania,

OSHEE sh.a. do të vendosë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga Kompania, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. OSHEE Group sh.a do të bashkëpunojë me kërkesën e Kompanisë për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

9. Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

